



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 18.06.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 17.06.2026, të parashtruar nga " MIMOZA 1985 " SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me lule dhe kurora " , Nr. i prokurimit- 632-26-3086-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-26-014-121, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "MIMOZA 1985" SH.P.K., e dt.02.06.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me lule dhe kurora " , Nr. i prokurimit- 632-26-3086-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-26-014-121, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 12.06.2026, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: **12.06.2026;**

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "MIMOZA 1985" SH.P.K., me dt.17.06.2026, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me lule dhe kurora " , Nr. i prokurimit- 632-26-3086-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-26-014-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 18.06.2026, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet e juaja janë të pabazuara sepse:

-Autoriteti kontraktues ka shpërblyer me kontratë Operatorin ekonomik të përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

-Ju si Operator ekonomik nuk keni prezantuar listën e kontratave në të cilën specifikohen të gjitha furnizimet e realizuara në 3 (tre) vitet e shkuara, duke saktësuar furnizimet e kryera shumën e kontratës, datën e pranuesit ose certifikatën e ekzekutimit të mirë të furnizimeve- (së paku një referencë ose raport të pranimit të furnizimeve e

cila përputhet me listën e dorëzuar) dhe keni pasur çmimin më të lartë, duke mos plotësuar kështu kërkesat e Autoritetit Kontraktues siç është kërkuar në FDT, për çka edhe jeni eliminuar;

-Qasja në dokumentacion fillon menjëherë pas publikimit të Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit kontraktues (neni 7 paragrafi 7.2 i Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024), ku çdo Operator ekonomik mund të kërkojë qasje brenda afatit ligjor (neni 60, paragrafi 60.1 nën b) i rregullores), e jo kërkesa për qasje të dorëzohet bashkë me kërkesën për rishqyrtim siç keni vepruar ju;

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

